



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 25, dt. 01.02.2017

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim KKR nr. 75, date 03.04.2015 "Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit", në mbledhjen e dt. 01.02.2017 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për heqje të licencës së Restaurimit të dhënë shoqërisë "KARL GEGA KONSTRUKSION" sh.p.k për shkak të paraqitjes së dorëheqjes së drejtuesit Teknik Ark. Shpresa Prifti nga kjo shoqëri si dhe të shqyrtimit të kërkesës për dhënie license në fushën e restaurimit për Shoqërinë "2 T" shpk, me drejtues teknik Ark. Rest. Shpresa Prifti (RP 32),

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për heqjen e licencës së shoqërisë "KARL GEGA KONSTRUKSION" sh.p.k për shkak të mbetjes pa drejtues teknik restaurator.
2. Të miratojë kërkesën e Shoqërisë "2 T" shpk me drejtues ligjor Z. Artan Sako për pajisje me licensë restaurimi për kategorinë:
"CP. Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi me drejtues teknik Ark. Shpresa Prifti (R.P 32).
3. T'i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licensë restaurimi për Shoqërinë "2 T" shpk, për kategoritë:
"CP. Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi me drejtues teknik Ark. Shpresa Prifti (R.P 32).
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

ARTA DOLLANI